



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. Org. Jedin Org Unit	0113	Nr. Prof. Br. Prof Prof.No:	1060
Nr. i fletëve Broj stranica No. pages	-	Datum: Date:	27.03.23
PRISHTINE/A			NO.1

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Joint Stock Companies
Trepça Deoničarsko Društvo
Nr. 1643 Data: 24-03-2023
Mitrovicë Mitrovica

RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2022 PËR NDËRMARRJEN
TREPÇA SH.A.

Mitrovicë, Shkurt 2023

Përmbajtja

Lista e tabelave.....	3
Lista e figurave	4
Hyrje	5
1. Aktivitetet dhe përforma e ndërmarrjes Trepça Sh.A.	7
1.1. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	8
1.2. Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes	9
1.3. Ngjarjet të cilat kanë ndikuar negativisht	9
1.4. Informatat lidhur me Bordin Mbikëqyrës	10
1.5. Ngjarjet dhe arritjet kryesore të vitit	12
1.6. Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit	13
1.7. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Tunelit të Parë dhe flotacionin e Kishnicës	14
1.7.1. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Tunelit të Parë	14
1.7.2. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Kishnicës	16
1.7.3. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Leposaviqit	18
2. Pasqyrat e performancës financiare dhe rezultatet.....	20
3. Progresi me planin e biznesit	25
3.1. Pasqyrë e progresit në implementimin e planit të biznesit	25
4. Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjive në ndërmarrjen Trepça Sh.A.....	28
4.1. Ndryshimet e nevojshme të cilat do të ndikojnë në arritjen e objektivave të planit të biznesit....	28
4.2. Rreziqet e të ardhmes së korporatës	29
4.3. Investimet kapitale nga BRK.....	31
4.4. Investimet kapitale nga buxheti vetanak	32
ANNEX 1	33

Lista e tabelave

Tabel 1. 1. Performanca vjetore e eksploatimit, prodhimit dhe të hyrave	8
Tabel 1. 2. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Tunelit të Parë gjatë viteve 2021, 2022	14
Tabel 1. 3. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Kishnicës gjatë viteve 2021, 2022	16
Tabel 1. 4. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022	18
Tabel 1. 5. Të hyrat nga shitja e koncentratit nga flotacioni i Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022	19
Tabel 2. 1. Pasqyra e pozitës financiare që përfundon me 31.12.2022	20
Tabel 2. 2. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me 31.12.2022	20
Tabel 2. 3. Pasqyra e ndryshimit në ekuitet për vitin që përfundon me 31.12.2022	23
Tabel 2. 4. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon me 31.12.2022	24
Tabel 3. 1. Progresi i prodhimit të koncentratit të plumbit 2022	25
Tabel 3. 2. Progresi i prodhimit të koncentratit të zinkut 2022	25
Tabel 3. 3. Prodhimi i koncentratit të Pb dhe Zn për vitin 2022 për tri Njësitë Biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg, Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç	26
Tabel 3. 4. Progresi i të hyrave në raport me planin	26
Tabel 3. 5. Të hyrat e realizuara nga shitja e koncentratit të plumbit dhe zinkut nga tri njësitë prodhuese biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg, Miniera me Flotacion Kishnic dhe Artanë dhe Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç	28
Tabel 4. 1. Investimet kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. nga BRK 2022	31
Tabel 4. 2. Investimet kapitale nga buxheti vetanak në Trepça Sh.A.	32

Lista e figurave

Figura 1. 1. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Tunelit të Parë gjatë viteve 2021, 2022	15
Figura 1. 2. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Kishnicës gjatë viteve 2021, 2022	17
Figura 1. 3. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022.....	18
Figura 1. 4. Të hyrat nga shitja e koncentratit nga flotacioni në Leposaviq gjatë viteve 2021, 2022	19

Fjala e kryesuesit të Bordit Mbikëqyrës të Drejtorëve të NP "Trepça", Sh.A.

Në funksion të kryerjes së detyrave në mirëbesim të përcaktuara nga ligjet në fuqi, gjatë vitit 2022 Bordi Mbikëqyrës i Drejtorëve të NP "Trepça", Sh.A., ka synuar realizimin e objektivave nga Plani i biznesit për vitin 2022 për realizimin e të hyrave sa më të larta, zvogëlimin e shpenzimeve dhe rritjen afatgjate të vlerës së ndërmarrjes përmes investimeve të vazhdueshme kapitale, në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike.

Megjithëse Bordi Mbikëqyrës i Drejtorëve në këtë përbërje është emëruar me 02.02.2022 (pra deri në këtë datë ndërmarrja nuk ka pasur Bord Mbikëqyrës që nga muaji nëntor i vitit paraprak), ky Bord i Drejtorëve ka vazhduar punën për vitin 2022 dhe në mënyrë të suksesshme është ballafaquar me vështirësitë, problemet dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të tij. Duhet theksuar se si ndërmarrje publike kemi vazhduar realizimin e objektivave të planit të biznesit për vitin 2022 i përgatitur dhe aprovuar nga Bordi paraprak dhe pastaj me Planin e Rishikuar të biznesit. Edhe pse kemi gjetur ndërmarrjen në një gjendje të rëndë financiare me borxhe të akumuluar, me likuiditet në nivel të ulët, me mjete dhe pajisje të vjetërsuara, me pretendime gjyqësore përmbarimore për obligimet nga e kaluara, me hierarki të çrregulluar funksionale, me ushtrues detyre të pozitive kryesore të qeverisjes së ndërmarrjes, me probleme sociale të punësuarve, etj. janë ndërmarrë veprime me qëllim të stabilizimit të prodhimit dhe sigurimit të të hyrave më të mëdha, uljes së shpenzimeve, rritjes së disiplinës financiare duke caktuar kufizimet e furnizimeve të domosdoshme, prioritetet e pagesave dhe ngritjes së nivelit të raportimit financiar brenda ndërmarrjes por edhe të raportimit për Njësinë për Politika dhe Monitorim të NP.

Gjatë këtij viti edhe pse niveli i prodhimit, eksportimit të xehes ka qenë në nivel më të ulët se sa ka qenë i planifikuar, për shkak të përbërjes kualitative të xehes janë prodhuar sasi më të mëdha të koncentrateve të plumbit dhe zinkut. Tri arritjet më rëndësishme të cilat i kisha veçuar nga arritjet tjera për vitin 2022 janë: zvogëlimi i shpenzimeve operative, ngritja e nivelit të raportimit financiar dhe rekrutimi i 210 punëtorëve të rinj prej të cilëve grupi i parë prej 60+30 e kanë kryer praktikën.

Në aspektin financiar rritja e çmimeve të metaleve në bursë dhe rritja e dollarit në raport me valutat tjera ka ndikuar pozitivisht. Natyrisht se duhet të vazhdojë procesi i riorganizimit, një sfidë e së ardhmes paraqet hartimi i strategjisë zhvillimore për "Trepçën" dhe ristrukturimi, sistematizimi dhe zgjidhja e çështjeve sociale për të punësuarit, të cilat janë objektiva për vitin 2023 por edhe në përgatitjen e ndërmarrjes për Fondin Sovran.

Nga NJB jothelbësore NJB Industria kimike ka rritur prodhimin e aluminiut sulfatit me të cilin furnizohen pjesa më e madhe e kompanive rajonale të ujësjellësve e që në periudhën paraprake ky artikull i domosdoshëm për pastrimin e ujit të pijshëm importohet. Terminali Doganor i riaktivizuar në Parkun Industrial në fund të vitit 2021 gjatë këtij viti është funksionalizuar plotësisht.

Gjatë këtij viti për shkak të vjetërsisë së aseteve jemi përballë me disa avari (ndërprerja e rrymës, pajisja elektro-makinike në flotacion) të cilat kanë ndikuar në ndërprerjen e përkohshme të procesit të prodhimit dhe rrjedhimisht kanë kufizuar të hyrat nga shitja. Po ashtu për shkak të rritjes shumë të lartë të çmimit të energjisë elektrike jemi ballafaquar me shpenzime të larta, të papërbalueshme në këtë nivel nga "Trepça", por që me ndihmën e Qeverisë e cila është aksionare e 80% të aksioneve kjo gjendje është tejkaluar.

Synimi jonë është që edhe në të ardhmen të vazhdojmë që në fokusin tonë të kemi rritje të të hyrave përmes rritjes së prodhimit, rritjes së efijencës në shfrytëzimin dhe pasurimin e xehes, përmes rritjes së nivelit të investimeve kapitale në revitalizimin e minierave dhe flotacioneve dhe në anën tjetër duke zvogëluar shpenzimet operative me qëllim të maksimizimit të fitimit.

Si kryesues i Bordit Mbikëqyrës, me këtë rast vlerësoj, se bashkëpunimi i ngushtë në nivelin e qeverisjes korporative në mes të anëtarëve të Bordit, me anëtarët e Bordit Menaxhues, Zyrtarëve të lartë dhe Menaxhmentit nuk ka munguar prandaj edhe dua të falënderojë, Bordin Menaxhues, Zyrtarët e lartë dhe Menaxhmentin për punën e shkëlqyeshme, mbështetjen operative dhe përkrahjen e pa rezerve për anëtarët e Bordit.

Me respekt!

Hyrje

Raporti vjetor është një raport gjithëpërfshirës për aktivitetet e Ndërmarrjes Trepça Sh.A. dhe të performancës përgjatë vitit 2022. Ky raport siguron për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe grupet e tjera të interesit vlerësime të ekuilibruara dhe të kuptueshme për performancën e ndërmarrjes Trepça Sh.A. përgjatë vitit 2022 dhe perspektivat e saj në të ardhmen.

Ky raport përfshinë raportin e Kryesuesit të Bordit Mbikëqyrës dhe raportin e UD Kyeshetit Ekzekutiv të ndërmarrjes Trepça Sh.A si dhe menaxhimin e rrezikut duke theksuar rreziqet kryesore në biznes dhe politikat e miratuara të menaxhimit të rrezikut për të shmangur ose larguar ato rreziqe.

Pasqyrat Financiare Vjetore duke përfshirë; Pasqyrën e të ardhurave, Pasqyrën e pozicionit financiar, Pasqyrën e ndryshimit në ekuitet, Pasqyrën e rrjedhjes të parasë së gatshme, Pasqyrën e progresit në implementimin e planit të biznesit si dhe pasqyrën e investimeve kapitale në ndërmarrjen Trepça Sh.A. gjatë vitit 2022.

1. Aktivitetet dhe përformanca e ndërmarrjes Trepça Sh.A.

Gjatë vitit 2022 në ndërmarrjen Trepça, pos eksploatimit të xehes në dy minierat aktive, minierën e Stan Tergut dhe minierën e Artanës, dhe prodhimit të koncentratit në Flotacionin e Tunelit të parë dhe në Flotacionin e Kishnicës, janë bërë edhe shumë punë tjera përgatitore të cilat janë shumë të rëndësishme për procesin e prodhimit, të xehes dhe koncentratit.

Gjatë vitit 2022 në minierën e Stan Tërgut, nga punishtet e horizontit të VIII, IX, X, XI janë eksploatuar 162,578.50 ton xehe, me kualitet mesatar Pb -3.13 %, Zn-2.87% dhe Ag 52.03 gr/t. Kjo xehe e eksploatuar është transportuar në Flotacionin Tuneli i parë ku është flotuar dhe nga e cila janë fituar 5,059.00 ton koncentrat Pb me kualitet mesatar Pb- 69.48 % dhe 5,768.00 ton koncentrat Zn me kualitet mesatar Zn- 47.93 %.

Në minierën e Artanës gjatë viti 2022 janë eksploatuar 36,390.00 ton xehe me kualitet mesatar Pb -2.15 %, dhe Zn 2.93 %. Në Flotacionin e Kishnicës gjatë vitit 2022 janë flotuar 27,082.20 ton xehe, nga e cila janë fituar 755.00 ton koncentrat Pb me kualitet mesatar Pb - 61.70 % dhe 1,385.00 ton koncentrat Zn me kualitet mesatar Zn - 41.91%.

Gjatë muajve Janar, Shkurt, të vitit 2022 në Flotacionin e Kishnicës nuk është punuar në flotimin e xehes, për shkak të temperaturave të ulëta dhe ngricave, por kjo kohë është shfrytëzuar në renovimin e shumë defekteve në stabilimentet e Flotacionit dhe në punët përgatitore për fillimin e prodhimit.

Në vazhdim të raportit do të prezantohet një pasqyrë e performancës vjetore e eksploatimit të xehes, prodhimit të koncentratit dhe të hyrave të përgjithshme në ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Gjatë vitit 2022 në Njësinë Biznesore Industria Kimike ka pasë një realizim të mirë të hyrave vjetore në vlerë prej 131,719.00 Euro.

Njësia Biznesore Industria Kimike ka lidhur kontrata për shitjen e produktit (sulfat alumini) me 4 kompani rajonale; KRU Prishtina, KRU Hidromorava Gjilan, KRU Bifurkacioni Ferizaj, KRU Mitrovica në Mitrovicë gjithësejt vlera e kontratave në vlerë prej 233.000 Mije Euro.

Për shfrytëzim të ujit industrial momentalisht janë 3 kontrata gjithësejt në vlerë prej 650 Euro per vitin 2022, ndërsa kontrata të lidhura për Qera janë 13 kontrata aktive me periudhë kohore 3 vjeçare vlera e kontratave vjetore në vlerë prej 36,228.00 Euro.

Tabel 1. 1.Performanca vjetore e eksploatimit, prodhimit dhe të hyrave

	Viti 2022	Viti 2021	Raporti
Prodhimi i koncentratit të Pb & Zn			
K/Pb	5,814.00	5,600.00	3.82%
K/Zn	7,153.00	7,321.00	-2.29%
Të hyrat			
Të hyrat nga shitja e K/Pb & K/Zn	16,153,948.00	13,723,144.00	17.71%
Të ardhurat tjera	7,322,912.00	7,198,586.00	1.73%
Të ardhurat financiare		47,347.00	
Të hyrat në total	23,476,860.00	20,969,077.00	11.96%

Nga tabela shihet se prodhimi i koncentratit të plumbit në vitin 2022 ishte 3.82% më i lartë krahasuar me vitin 2021 ndërsa prodhimi i koncentratit të zinkut në vitin 2022 ishte -2.29 % më i ultë në raport me vitin 2021. Poashtu edhe të hyrat e përgjithshme vjetore në ndërmarrjen Trepça Sh.A. në vitin 2022 ishin më të larta për 11.96 % krahasuar me vitin 2021.

1.1. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden

Kapitali themeltar i Trepça Sh.A. është 10,000.00€ dhe është i ndarë në 10,000 aksione me vlerë nominale 1€ secili.

Bordi Mbikëqyrës përcakton dividendin dhe shpërndarja e dividendit do të bëhet vetëm me autorizim të aksionarit. Dividenti që u takon aksionarëve sipas pjesëmarrjes së tyre në aksione evidentohet dhe paguhet në nivel të njësisë biznesore duke u bazuar në rezultatin financiar të saj.

Trepça Sh.A. për shkak të disa pengesave administrative në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës nuk ka arritur të bëjë regjistrimin e punëtorëve si aksionarë të 20% të aksioneve të Trepçës dhe si pasojë e gjendjes financiare nuk ka arritur të bëjë as shpërndarjen e dividendëve. Trepça Sh.A., aktualisht nuk ka ndonjë kredi.

1.2. Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Si ngjarje kryesore pozitive që ndikojnë në të ardhmen e Trepçës janë:

- Rritja e nivelit dhe konsolidimi i prodhimit në njësitë biznesore eksploatuese-prodhuese;
- Vazhdimi i prodhimit të aluminiut sulfatit në NJB-Industria Kimike dhe penetrimi në tregjet e reja;
- Trendi i ngritjes së çmimit të metaleve në bursën e Londrës në bazë të të cilave Trepça bën shitjen e koncentrateve;
- Kontratat e favorshme për shitjen e koncentratit, ku rol të madh luan çmimi-shpenzimet e përpunimit të metaleve, dhe faktorët tjerë determinues;
- Rritja e të hyrave nga terminali doganor;
- Valorizimi i mbetjeve industriale teknologjike për gjenerimin e të hyrave dhe mbrojtjen e ambientit;
- Miratimi i rregulloreve të reja në ndërmarrjen Trepça Sh.A.;
- Zbatimi i pakos softverike për kontabilitet (ku do të luan një rol të madh pasi që do të bëhet menaxhimi i kontabilitetit të integruar të materialit financiar, kontabiliteti i kostos, moduli për evidencën e materialeve të inventarit dhe paisjeve rezerve, menaxhimi dhe përlllogaritja e pagave, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi i aseteve, raportet menaxheriale dhe raportet financiare etj);
- Çertifikimi i 60 kandidatëve për punën praktike në ndërmarrjen Trepça Sh.A
- Rritja e të hyrave nga shitja e koncentratit të Plumbit dhe Zinkut.

1.3. Ngjarjet të cilat kanë ndikuar negativisht

- Kostoja e lartë e furnizimit me energji elektrike;
- Investimet kapitale ende në nivel të ulët,
- Pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik përmes përmbauesve.
- Greva njëjavore në njësinë biznesore minierat me Artanës me Floatcion Kishnicës;
- Defektet në kabllon furnizuese me energji elektrike në minierën e Stan Tërgut, kanë rrezikuar përmbytjen e minierës nga ujërat nëntokësorë në horizontin e XI,

- Defektet në flotacion në Tunelin e parë në pllakën komanduese startuese të mullirit dhe peshore.
- Moshë e shtyer të punësuarëve sidomos në miniera,
- Mungesa e ligjeve për zgjidhjen e çështjeve sociale të minatorëve (stazhi i beneficuar, pensioni, etj)
- Mungesa e Bordit Mbikëqyrës në fund të vitit 2021 dhe fillim të vitit 2022,
- Ndërprerjet e shpeshta të rrymës elektrike si rezultat i dëmeve të shkaktuar nga distribuimi i tensionit në HC Hydroline në Selac.
- Zhvlerësimi i lartë dhe vjetërsimi i aseteve.

1.4. Informatat lidhur me Bordin Mbikëqyrës

Gjatë vitit 2022 Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A ka mbajtur njëzet mbledhje të rregullta dhe drejtorët kanë marrë pjesë vazhdimisht me përjashtim të ndonjë rasti me arsye. Gjatë vitit 2022 Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A ka mbajtur dy mbledhje të jashtëzakonshme. Me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 01/58 të datës 02.02.2022 emerohen këta kandidatë për anëtarë të Bordit Mbikëqyrës.

1. Bahri Hyseni – Kryesues
2. Ibrahim Krasniqi – anëtar
3. Muharrem Peci – anëtar
4. Bujar Bilalli – anëtar
5. Xhevdet Tahiri – anëtar

Mandati i të emeruarëve sipas këtij vendimi të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr 01/58 të datës 02.02.2022 zgjat katër (4) vjet. Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me ligjin Nr.03/L-087 për Ndermarrjet Publike , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr .04/L-111 dhe Ligjit Nr.05/L-009, në pajtim me Ligjin Nr 05/L-120 për Trepçën si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Me datën 11.02.2022 sipas vendimit me nr të protokollit 794 i datës 16.02.2022 është emëruar Komiteti i Auditimit me këtë përbërje:

1. Bujar Bilalli – Kryesues

2. Muharrem Peci – anëtar
3. Xhevdet Tahiri – anëtar

Gjatë vitit 2022 Komisioni i Auditimit i Trepça Sh.A ka mbajtur njëmbëdhjetë mbledhje të rregullta dhe drejtorët kanë marrë pjesë vazhdimisht me përjashtim të ndonjë rasti me arsye.

Komiteti i Auditimit kryen detyrat sipas dispozitave të Ligjit për Trepçën nr 05/L-120, dispozitave të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndermarrjet Publike , Ligjit nr .04/L-111 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet Publike, Ligjit nr.06/L-016 për Shoqerit tregtare si dhe Statutit te Trepça Sh.A.

Kompenzimi për anëtarëve të Komitetit të Auditimit bëhet sipas vendimit të Qeverisë nr.01/08 të datës 09.10.2018 dhe vendimit nr.07/81,pika 1.1 i datës 23.03.2016.

Bordit Mbikëqyrës i Ndërmarrjes Trepça Sh.a nga mbledhja e parë e Bordit që nga data 04.02.2022 deri me datën 28.12.2022 ka nxjerrë 102 vendime nga mbledhjet e rregullta , ndërsa nga mbledhjet e jashtëzakonëshme Bordi Mbikëqyrës i Ndërmarrjes Trepça Sh.a ka nxjerrë 5 vendime.

Komisioni i Auditimit i Ndërmarrjes Trepça Sh.a nga data 23.02.2022 deri me datën 21.12.2022 ka nxjerrë 23 vendime nga mbledhjet e rregullta.

Ndërmarrja Trepça Sh.a ka të miratuara gjithësejt dymbëdhjetë Rregullore ndërsa vetëm për vitin 2022 Bordi Mbikëqyrës i Ndërmarrjes Trepça Sh.a ka nxjerrë shtatë rregullore :

Rregullore për Sigurinë dhe Shëndetin në Pune në Trepça SH.A. (11.02.2022).

Rregullore për Shpenzimet e telefonave Mobil në Trepça SH.A. (16.02.2022).

Rregullore për Reprezentacion ne Trepça SH.A. (16.02.2022).

Rregullore për përdorimin e Automjeteve Zyrtare të Trepça SH.A. (03.03.2022).

Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësim të Rregullores nr. 734 të datës 11.02.2021 për procedurat e avancave dhe shpenzimeve me paranë e imët (petty-cash) dhe avancat për udhëtime zyrtare në Trepça SH.A. (25.11.2022).

Rregullore për provizionimin e Llogarive të Arkëtueshme në Trepça SH.A. (25.11.2022).

Rregullore për ndihma solidare në Trepça SH.A. (28.12.2022).

1.5. Ngjarjet dhe arritjet kryesore të vitit

- Zvogëlimi i shpenzimeve të energjisë;
- Miratimi i Planit të Biznesit për vitin 2023;
- Ngritja e efijencës në procesin e eksploatimit dhe flotimit (nga sasi më e ulët e eksploatimit të xehes prodhim më i lartë dhe më cilësor i koncentratit të Plumbit dhe Zinkut);
- Heqja e shtesave në paga të punëtorëve të ekzekutuara pa asnjë bazë ligjore;
- Riaktivizimi i linjës së dytë për furnizim me energji elektrike në minierën e StanTërgut;
- Ngritja e të hyrave nga NJB-Industria Kimike;
- Arritja e kontratave të favorshme për shitjen e Plumbit dhe Zinkut;
- Ngritja e të hyrave dhe funksionalizimi i Terminalit Doganor;
- Rritja e nivelit të arkëtimit të llogarive të arkëtueshme të ndërmarrjes Trepça Sha. përmes procedurave të përmbartimit;
- Zvogëlimi i shpenzimeve operative;
- Çertifikimi i 60 kandidateve për punën praktike në ndërmarrjen Trepça Sh.A.;
- Pranimi i donacionit pako softveurike për kontabilitet në vlerë prej 99,900.00€;
- Pranimi i donacionit nga KFOR-i Hungarez për çetën e shpëtimit në vlerë prej 34,865.00 €;
- Miratimi i shtatë rregulloreve të reja të ndërmarrjes Trepça Sh.A për vitin 2022;
- Paditë e fituara për kompenzimin e shpërblimeve jubilarë për vitin 2022;
- Inicimi i procedurave gjyqësore ndaj kontesteve të demeshme për fitimin e humbur;
- Rastet e fituara në proceset gjyqësore gjegjësisht ndaj aplikimit të masës së sigurisë;
- Ngritja e kallëzimeve penale ndaj uzurpimeve të pronave të ndërmarrjes Trepça Sh.A.;
- Hapja e menzës për punëtorët e Kishnicës.

1.6. Çështjet kyçe që janë paraqitur gjatë vitit

- Ngritja globale (enorme) e çmimeve të energjisë elektrike ka dëmtuar në masë të madhe afarizmin e ndërmarrjes Trepça Sh.A.;
- Ngritja e çmimit të metaleve në berzën ndërkombëtare të shitjes së metaleve (LME);
- Kërkesat sociale të punëtorëve (stazhi i beneficuar, pensioni i parakohshëm, etj.);
- Qeveria ka treguar një interesim më të madh me hapat konkret duke ndarë mjete për subvencione për pagesën e energjisë elektrike si dhe në investime kapitale.

1.7. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Tunelit të Parë dhe flotacionin e Kishnicës

1.7.1. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Tunelit të Parë

Tabel 1. 2. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Tunelit të Parë gjatë viteve 2021, 2022

Muajt	Flotacioni në Tunelin e Parë - Krahasimi i rezultateve të prodhimit të koncentratit gjatë viteve 2022, 2021 dhe me planin e prodhimit 2022															
	Viti 2022		Viti 2021		Plani i prodhimit për vitin 2022		Ndryshimi në (%) - 2022, 2021		Ndryshimi në (t) - 2022, 2021		Ndryshimi në (%) - 2022, plani i prodhimit 2022		Realizimi i planit 2022			
	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (%)	K/Zn (%)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (%)	K/Zn (%)	K/Pb (%)	K/Zn (%)		
Janar	360.00	475.00	420.00	450.00	622.96	589.12	-14.29%	5.56%	-60.00	25.00	-262.96	-114.12	-42.21%	-19.37%	57.79%	80.63%
Shkurt	380.00	611.00	440.00	550.00	569.60	640.36	-13.64%	11.09%	-60.00	61.00	-189.60	-29.36	-33.29%	-4.58%	66.71%	95.42%
Mars	230.00	300.00	440.00	505.00	661.44	773.64	-47.73%	-40.59%	210.00	-205.00	-431.44	-473.64	-65.23%	-61.22%	34.77%	38.78%
Prill	615.00	735.00	390.00	520.00	726.76	817.56	57.69%	41.35%	225.00	215.00	-111.76	-82.56	-15.38%	-10.10%	84.62%	89.90%
Maj	320.00	340.00	410.00	344.00	711.20	817.68	-21.95%	-1.16%	-90.00	-4.00	-391.20	-477.68	-55.01%	-58.42%	44.99%	41.58%
Qershor	400.00	550.00	695.00	700.00	580.11	751.64	-42.45%	-21.43%	295.00	-150.00	-180.11	-201.64	-31.05%	-26.83%	68.95%	73.17%
Korrik	350.00	577.00	528.00	600.00	545.06	735.85	-33.71%	-3.83%	178.00	-23.00	-195.06	-158.85	-35.79%	-21.59%	64.21%	78.41%
Gusht	380.00	550.00	245.00	280.00	637.30	853.84	55.10%	96.43%	135.00	270.00	-257.30	-303.84	-40.37%	-35.59%	59.63%	64.41%
Shtator	450.00	520.00	360.00	420.00	747.81	813.41	25.00%	23.81%	90.00	100.00	-297.81	-293.41	-39.82%	-36.07%	60.18%	63.93%
Tetor	400.00	380.00	200.00	270.00	744.26	851.14	100.00%	40.74%	200.00	110.00	-344.26	-471.14	-46.26%	-55.35%	53.74%	44.65%
Nëntor	420.00	445.00	313.00	582.00	741.50	860.55	34.19%	-23.54%	107.00	-137.00	-321.50	-415.55	-43.36%	-48.29%	56.64%	51.71%
Dhjetor	754.00	285.00	343.00	444.00	751.76	600.00	119.83%	-35.81%	411.00	-159.00	2.24	-315.00	0.30%	-52.50%	100.30%	47.50%
Gjithësejt	5,059.00	5,768.00	4,784.00	5,665.00	8,039.76	9,104.79	5.75%	1.82%	275.00	103.00	-2,980.76	-3336.79	-37.08%	-36.55%	62.92%	63.35%




Figura 1. 1. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Tunelit të Parë gjatë viteve 2021, 2022

Gjatë vitit 2022 në flotacionin Tuneli i Parë janë prodhuar 378.00 ton koncentrat Pb dhe Zn më shumë se sa gjatë viti 2021, apo shprehur në përqindje 3.62 % ndërsa nëse e krahasojmë prodhimin e koncentrateve veç e veç gjatë këtyre viteve do të kemi:

Gjatë vitit 2022, ka pasur prodhim më të lartë të koncentratit Pb për 275.00 ton ose shprehur në përqindje për 5.74 % në krahasim me prodhimin e koncentratit të Pb gjatë vitit 2021. Ndërsa ka pasë prodhim më të lartë të koncentratit të Zn për 103.00 ton, ose shprehur në përqindje për 1.82 %.

Gjatë vitit 2022 në flotacionin Tuneli i Parë janë prodhuar -6,317.55 ton koncentrat Pb dhe Zn më pak se sa që është planifikuar për vitin 2022, apo shprehur në përqindje -36.84 % ndërsa nëse e krahasojmë prodhimin e koncentrateve që është prodhuar gjatë vitit 2022 veç e veç me prodhimin e planifikuar 2022 do të kemi:

Gjatë vitit 2022, ka pasur prodhim më të ulët të koncentratit Pb se sa prodhimi i planifikuar për -2,980.76 ton ose shprehur në përqindje për -37.07 % si dhe prodhim gjithashtu më të ulët të koncentratit të Zn për -3,336.79 ton, ose shprehur në përqindje për -36.65 %. Plani i prodhimit të koncentratit të Pb për vitin 2022 në flotacionin Tuneli i parë, është realizuar 62.92 % ndërsa plani i prodhimit të koncentratit të Zn është realizuar 63.35 %.

1.7.2. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Kishnicës

Tabel 1. 3. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Kishnicës gjatë viteve 2021, 2022

Muajt	Flotacioni në Kishnicë - Krahasimi i rezultateve të prodhimit të koncentratit gjatë viteve 2022, 2021 dhe me planin e prodhimit 2022													
	Viti 2022		Viti 2021		Plani i prodhimit për vitin 2022		Ndryshimi në (%) - 2022, 2021		Ndryshimi në (t) - 2022, 2021		Ndryshimi në (%) - 2022, plani i prodhimit 2022		Realizimi i planit 2022	
	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (%)	K/Zn (%)	K/Pb (t)	K/Zn (t)	K/Pb (%)	K/Zn (%)	K/Pb (%)	K/Zn (%)
Janar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
Shkurt	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	0.00	0.00	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	#DIV/0!	
Mars	71.00	110.00	0.00	0.00	71.00	110.00	#DIV/0!	#DIV/0!	-54.00	-140.00	-43.20%	-56.00%	56.80%	
Prill	95.00	170.00	70.00	157.00	125.00	250.00	35.71%	8.28%	-30.00	-80.00	-24.00%	-32.00%	76.00%	
Maj	78.00	170.00	120.00	230.00	125.00	250.00	-42.00	-26.09%	-47.00	-80.00	-37.60%	-32.00%	62.40%	
Qershor	55.00	130.00	105.25	214.00	125.00	250.00	-50.25	-39.25%	-70.00	-120.00	-56.00%	-48.00%	44.00%	
Korrik	52.00	140.00	111.00	225.00	125.00	250.00	-59.00	-37.78%	-73.00	-110.00	-58.40%	-44.00%	41.60%	
Gusht	59.00	119.00	90.00	184.00	150.56	303.90	-31.00	-34.44%	-91.56	-184.90	-60.81%	-60.84%	39.19%	
Shtator	90.00	146.00	89.00	184.00	153.69	310.23	1.00	-20.65%	-63.69	-164.23	-41.44%	-52.94%	58.56%	
Tetor	50.00	100.00	91.00	181.00	167.81	338.73	-41.00	-44.75%	-117.81	-238.73	-70.20%	-70.48%	29.80%	
Nëntor	150.00	200.00	75.00	151.00	168.12	339.36	75.00	100.00%	-18.12	-139.36	-10.78%	-41.07%	89.22%	
Dhjetor	55.00	100.00	65.00	130.00	181.92	367.22	-10.00	-15.38%	-126.92	-267.22	-69.77%	-72.77%	30.23%	
Gjithsejt	755.00	1,385.00	816.25	1,656.00	1,447.10	2,909.44	-61.25	-7.50%	-692.10	-1,524.44	-47.83%	-52.40%	52.17%	
													47.60%	




Figura 1. 2. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Kishnicës gjatë viteve 2021, 2022

Gjatë vitit 2022 në flotacionin e Kishnicës janë prodhuar -332.25 ton koncentrat Pb dhe Zn më pak se sa gjatë viti 2021, apo shprehur në përqindje -13.43 % ndërsa nëse e krahasojmë prodhimin e koncentrateve veç e veç gjatë këtyre viteve do të kemi:

Gjatë vitit 2022, ka pasur prodhim më të ulët të koncentratit Pb për -61.25 ton ose shprehur në përqindje për 7.50 %, gjithashtu ka pasë prodhim më të ulët të koncentratit të Zn për -271.00 ton, ose shprehur në përqindje për -16.36 %.

Gjatë vitit 2022 në flotacionin e Kishnicës janë prodhuar -2,216.54 ton koncentrat Pb dhe Zn më pak se sa që është planifikuar për vitin 2022, apo shprehur në përqindje -50.87 %, ndërsa nëse e krahasojmë prodhimin e koncentrateve që është prodhuar gjatë viti 2022 veç e veç me prodhimin e planifikuar 2022 do të kemi:

Gjatë vitit 2022, ka pasur prodhim më të ulët të koncentratit Pb se sa prodhimi i planifikuar për -692.10 ton ose shprehur në përqindje për -47.83 % si dhe prodhim gjithashtu më të ulët të koncentratit të Zn për -1524.44 ton, ose shprehur në përqindje për -52.40 %. Plani i prodhimit të koncentratit të Pb për vitin 2022 në flotacionin e Kishnicës është realizuar 52.17 % ndërsa plani i prodhimit të koncentratit të Zn është realizuar 47.60 %.

1.7.3. Prodhimi i koncentratit në Flotacionin e Leposaviqit

Tabel 1. 4. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022

Prodhimi i koncentratit të Pb dhe Zn në flotacionin e Leposaviqit					
	Muajt	Viti 2021 në (t)	Viti 2022 në (t)	Ndryshimi 2022-2021 në (t)	Ndryshimi 2022-2021 në (%)
1	Janar	899.00	1,024.00	125.00	13.90%
2	Shkurt	945.00	925.00	-20.00	-2.12%
3	Mars	1,019.00	1,026.00	7.00	0.69%
4	Prill	1,092.00	930.00	-162.00	-14.84%
5	Maj	917.00	945.00	28.00	3.05%
6	Qershor	887.00	680.00	-207.00	-23.34%
7	Korrik	932.00	703.00	-229.00	-24.57%
8	Gusht	1,032.00	1,021.00	-11.00	-1.07%
9	Shtator	845.00	1,055.00	210.00	24.85%
10	Tetor	919.00	1,023.00	104.00	11.32%
11	Nëntor	872.00	918.00	46.00	5.28%
12	Dhjetor	891.00	1,034.00	143.00	16.05%
13	Gjithsejt	11,250.00	11,284.00	34.00	0.30%




Figura 1. 3. Prodhimi i koncentratit në flotacionin e Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022

Në flotacionin e Leposaviqit gjatë viti 2022 janë prodhuar 11,284.00 ton koncentrat Pb dhe Zn, ndërsa gjatë vitit 2021 në këtë flotacion janë prodhuar 11,250.00 ton koncentrat Pb dhe Zn. Kjo do të thotë se gjatë vitit 2022 ka pasë prodhim më të lartë të koncentratit për 34.00 ton, ose shprehur në përqindje 0.30 %.

Tabel 1. 5. Të hyrat nga shitja e koncentratit nga flotacioni i Leposaviqit gjatë viteve 2021, 2022

Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb dhe Zn në flotacionin e Leposaviqit					
	Muajt	Viti 2021 në (€)	Viti 2022 në (€)	Ndryshimi 2022-2021 në (€)	Ndryshimi 2022-2021 në (%)
1	Janar	743,061.99	567,379.99	-175,682.00	-23.64%
2	Shkurt	867,228.60	1,909,748.23	1,042,519.63	120.21%
3	Mars	1,195,760.08	1,315,832.89	120,072.81	10.04%
4	Prill	1,190,669.40	1,455,522.05	264,852.65	22.24%
5	Maj	1,151,076.06	1,336,966.20	185,890.14	16.15%
6	Qershor	1,268,239.98	939,219.00	-329,020.98	-25.94%
7	Korrik	1,192,381.94	264,108.42	-928,273.52	-77.85%
8	Gusht	1,076,843.75	1,236,983.16	160,139.41	14.87%
9	Shtator	1,047,558.90	577,979.45	-469,579.45	-44.83%
10	Tetor	997,552.66	1,046,901.71	49,349.05	4.95%
11	Nëntor	1,159,841.50	1,087,057.86	-72,783.64	-6.28%
12	Dhjetor	482,304.91	953,162.96	470,858.05	97.63%
13	Gjithsejt	12,372,519.77	12,690,861.92	318,342.15	2.57%




Figura 1. 4. Të hyrat nga shitja e koncentratit nga flotacioni në Leposaviq gjatë viteve 2021, 2022

Nga flotacioni i Leposaviqit gjatë viti 2022 është shitur koncentrat Pb dhe Zn në vlerë 12,690,861.92 €, ndërsa gjatë vitit paraprak 2021 nga ky flotacion është shitur koncentrat në vlerë 12,372,519.77 €. Kjo do të thotë se gjatë vitit 2022 ka pasë shitje më të lartë të koncentratit të Pb dhe Zn në vlerë 318,342.15,€ ose shprehur në përqindje 2.57 %.

2. Pasqyra e ardhurave gjithëpërfshirëse

Tabel 2. 1. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me 31.12.2022

	Shënimi	2022	2021
Të hyrat	7	30,107,542	26,095,748
Kostoja e shitjes	8	25,815,321	(23,022,560)
Fitimi / (humbja) bruto		4,292,222	3,073,188
Të ardhurat tjera	7.1	8,434,950	7,900,096
Shpenzimet e shpërndarjes	9.2	2,371,708	3,433,080
Shpenzimet administrative	9.1	8,849,491	8,443,448
Shpenzimet e tjera		417,200	521,080
Fitimi / (humbja) operativ		1,088,773	(1,424,324)
Shpenzimet financiare	9.3	0	(32,312)
Të ardhurat financiare	7	0	47,347
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,088,773	(1,409,289)
Shpenzimet e tatimit në fitim	10		
Fitimi / (humbja) i/e vitit		1,088,773	(1,409,289)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		0	0
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:		0	0
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit:		1,088,773	(1,409,289)

Nga pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin 2022 rezulton se të hyrat nga shitjet e prodhimit (konc.Pb, Zn dhe Al sulfat) krahasuar me të hyrat e vitit paraprak 2021 janë më të larta për 15.37%. Përderisa kostja e shitjes për vitin 2022 rezulton të jetë më lartë për 12.13%. Viti 2022 në ndërmarrjen Trepça Sh.A. rezulton të ketë një fitim neto prej 1,088,773 €.

Tabel 2. 2. Pasqyra e pozitës financiare që përfundon me 31.12.2022

	Shënimi	2022	2021
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	2	392,997	1,007,718
Investimet financiare afatshkurtra		4,287,023	4,391,948
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3	7,757,568	6,782,456
Stoqet	4	27,772,319	29,240,460
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.1	2,226,739	1,266,490
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		42,436,646	42,689,072
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje		0	0
Investimet në filiale		0	0
Investimet financiare afatgjata		0	0
Prona, pajisjet dhe impiantet	1	153,044,443	154,450,447
Prona investuese		0	0
Investimet në vijim	1	0	0
Pasuritë e paprekshme		0	0
Pasuritë e shtyra tatimore		0	0
Pasuritë e tjera afatgjata		0	0
Gjithsej pasuritë afatgjata		153,044,443	154,450,447
Gjithsej pasuritë		195,481,089	197,139,519
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare	6	0	0
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6.2	7,813,697	8,973,802
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	6		0
Interesi i pagueshëm		9,357,061	8,212,375
Tatimin në fitim i pagueshëm	10	0	0
Provizionet afatshkurtra		0	0
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër		9,361,535	5285882
Detyrimet e tjera afatshkurtra	6	1,792,301	8,973,802
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		28,324,594	31,445,861
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	6	0	0
Provizionet afatgjata		0	0
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatgjatë		0	1,522,466
Detyrimet e shtyra tatimore		0	0
Detyrimet e tjera afatgjata	6	0	0
Gjithsej detyrimet afatgjata		1,826,973	1,522,466
Gjithsej detyrimet		30,151,567	32,968,327
EKUITETI			
Kapitali aksionar	5	190,284,908	190,215,350
Fitimet (Humbjet) e mbajtura	5	(26,044,158)	(24,634,869)
Fitimi i periudhës	5	1,088,773	(1,409,289)
Gjithsej ekuiteti		165,329,523	164,171,192
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		195,481,089	197,139,519

Te pasqyra e pozitës financiare për vitin 2022 kemi rrënje të pasurive afatshkurtëra për 0.59%, si rezultat i zvogëlimit të stoqeve. Rritje të llogarive të arkëtueshme për 14.38% si rezultat i shitjeve të fundit të koncentratit të Pb dhe Zn dhe barazimeve vjetore.

Te detyrimet afatshkurtëra kemi zvogëlim të detyrimeve për 9.93%, si rezultat i zvogëlim të detyrimeve ndaj furnitorëve. Përderisa kemi rritje të detyrimeve afatgjata si rezultat i rritjes së të hyrave të shtyra për 20%.

Te ekuitet kemi rrënje të ekuitet për 0.71%, si rezultat i zvogëlimit të stoqeve dhe zhvlerësimit, si dhe kemi zvogëlim të humbjes së përgjithshme si për 4.18% pasojë e fitimit të periudhës.

Tabel 2. 1. Pasqyra e ndryshimit në ekuitet për vitin që përfundon me 31.12.2022

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2021	165,820,443	(24,634,869)		141,185,574
Fitimi / (humbja) i/e vitit	0	(1,409,289)	0	(1,409,289)
Diferencat nga përkthimet valutore	0	0	0	0
Dividendat	0	0	0	0
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	24,394,907	0	0	24,394,907
Ndarja e rezervave	0	0	0	0
Gjendja më 31 dhjetor 2021	190,215,350	(26,044,158)	0	164,171,192
Gjendja më 1 janar 2022	190,215,350	(26,044,158)	0	164,171,192
Fitimi / (humbja) i/e vitit	0	1,088,773	0	1,088,773
Diferencat nga përkthimet valutore	0	0	0	0
Dividendat	0	0	0	0
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	69,558	0	0	69,558
Ndarja e rezervave	0	0	0	0
Gjendja më 31 dhjetor 2022	190,284,908	(24,955,385)		165,329,523

Te pasqyra e ndryshimit në ekuitet kemi rrënje të kapitalit, respektivisht rrënje të ekuitet për 0.71%, si rezultat i zvogëlimit të stoqeve dhe zhvlerësimit, si dhe kemi zvogëlim të humbjes së përgjithshme si për 4.18% pasojë e fitimit të periudhës.

Tabel 2. Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon me 31.12.2022

Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative	Shënimi	2022	2021
Fitimi / (humbja) para tatimit		1,088,773	(1,409,289)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	1	1,371,172	1,436,339
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		0	0
Amortizimi i pasurive të paprekshme		0	0
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		0	0
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			0
Të ardhurat financiare	7	0	
Shpenzimet financiare	9.3	0	32,312
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	7.1	0	0
Shpenzimet e tatimit në fitim	10	0	0
		1,127,427	59,362
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3	1,909,735	(45,692)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	4	287,822	(23,962,870)
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.1	960,249	(2,348,060)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	6.2	(926,785)	52,020
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	6	(2,402,446)	2,784,321
Tatimi në fitim i paguar	10	0	0
Interesi i paguar	9.3	0	(32,312)
		(721,557)	(23,832,231)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	1	(373,194)	(690,815)
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	7.1	0	0
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		0	0
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		0	0
Interesi i arkëtuar		0	0
Dividendat e arkëtuara		0	0
		(373,194)	(690,815)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë	5	(930,444)	24,394,907
Dividendat e paguara		0	0
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	6	0	0
Ripagimi i kredive dhe huave	6	0	0
Pagesat e lizingut financiar		0	519,384
		(930,444)	24,223,476
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		(347,636)	391,245
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	2	740,632	616,473
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		392,996	1,007,717

Pasqyra e rrjedhës së parasë tregon se Trepça Sh.A. po ballafaqohet me probleme financiare serioze duke marrë parasysh faktin se rrjedha neto e parase nga aktivitete operative, investive dhe financuese janë negative.

3. Progresi me planin e biznesit

3.1. Pasqyrë e progresit në implementimin e planit të biznesit

Viti 2022 ka qenë një nga vitet më të vështira për sa i përket furnizimeve me lëndë të parë për eksploatim e poashtu edhe për pasurim të mineralit për shkak të çrregullimit (ngritjes së çmimeve) të çmimeve si shkak i inflacionit. Edhe përkundër të gjitha vështirësive kemi arritë të mbajmë kontinuitetin e prodhimit të koncentrateve në Flotacionin Tuneli i Parë dhe Flotacionin në Kishnicë.

Tabel 3. 1. Progresi i prodhimit të koncentratit të plumbit 2022

Muaji	Planifikimi 2022			Realizimi 2022			Krahasimi i Planifikimit me Realizimin %
	Stan Tërg	Artanë	Gjithsejt ton	Stan Tërg	Artanë	Gjithsejt ton	
Janar	622.96	0	622.96	360	0	360.00	58%
Shkurt	569.6	0	569.60	380	0	380.00	67%
Mars	661.44	125	786.44	230	71	301.00	38%
Prill	726.76	125	851.76	617	95	712.00	84%
Maj	711.2	125	836.20	320	78	398.00	48%
Qershor	580.11	125	705.11	400	55	455.00	65%
Korrik	545.06	125	670.06	350	52	402.00	60%
Gusht	637.3	150.56	787.86	380	59	439.00	56%
Shtator	747.81	153.69	901.50	450	90	540.00	60%
Tetor	744.26	167.81	912.07	400	50	450.00	49%
Nëntor	741.5	168.12	909.62	420	150	570.00	63%
Dhjetor	751.76	181.92	933.68	754	55	809.00	87%
Gjithsejt	8,039.76	1,447.10	9,486.86	5,061.00	755.00	5,816.00	61%

Plani i prodhimit të koncentratit të Pb për vitit 2022 nga dy njësitë biznesore Miniera me Flotacion Stan Tërg dhe Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë krahasuar me planin e biznesit është realizuar 61%.

Tabel 3. 2. Progresi i prodhimit të koncentratit të zinkut 2022

Planifikimi 2022				Realizimi 2022			Krahasimi i Planifikimit me Realizimin %
Muaji	Stan Tërg	Artanë	Gjithsejt ton	Stan Tërg	Artanë	Gjithsejt ton	
Janar	589.12	0	589.12	475	0	475.00	81%
Shkurt	640.36	0	640.36	611	0	611.00	95%
Mars	773.64	250	1,023.64	300	110	410.00	40%
Prill	817.56	250	1,067.56	735	170	905.00	85%
Maj	817.68	250	1,067.68	340	170	510.00	48%
Qershor	751.64	250	1,001.64	550	130	680.00	68%
Korrik	735.85	250	985.85	577	140	717.00	73%
Gusht	853.84	303.9	1,157.74	550	119	669.00	58%
Shtator	813.41	310.23	1,123.64	520	146	666.00	59%
Tetor	851.14	338.73	1,189.87	380	100	480.00	40%
Nëntor	860.55	339.36	1,199.91	445	200	645.00	54%
Dhjetor	600.00	367.22	967.22	285	100	385.00	40%
Gjithsejt	9,104.79	2,909.44	12,014.23	5,768.00	1,385.00	7,153.00	62%

Plani i prodhimit të koncentratit të Zn për vitin 2022 nga dy njësitë biznesore Miniera me Flotacion Stan Tërg dhe Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë krahasuar me planin e biznesit është realizuar 62%.

Tabel 3. 3. Prodhim i koncentratit të Pb dhe Zn për vitin 2022 për tri Njësitë Biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Treçça Stan Tërg, Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç

Muaji	Realizimi 2022			Gjithsejt ton Pb+Zn
	Stan Tërg Pb+Zn (t)	Kishnicë dhe Artanë Pb+Zn(t)	Kopaonik-Leposaviç Pb+Zn(t)	
Janar	835.00	0.00	1,024.00	1,859.00
Shkurt	991.00	0.00	925.00	1,916.00
Mars	530.00	181.00	1,026.00	1,737.00
Prill	1,352.00	265.00	930.00	2,547.00
Maj	660.00	248.00	945.00	1,853.00
Qershor	950.00	185.00	680.00	1,815.00
Korrik	927.00	192.00	703.00	1,822.00
Gusht	930.00	178.00	1,021.00	2,129.00
Shtator	970.00	236.00	1,055.00	2,261.00
Tetor	780.00	150.00	1,023.00	1,953.00
Nëntor	865.00	350.00	918.00	2,133.00
Dhjetor	1,039.00	155.00	1,034.00	2,228.00
Gjithsejt	10,829.00	2,140.00	11,284.00	24,253.00

Tabel 3. 4. Progresi i të hyrave në raport me planin

Nr.	Përshkrimi	Plani Fillestar (€)	Rishikimi (€)	Realizimi 2022 (€)	Krahasimi i Planifikimit me Realizimin %
1	Të hyrat nga shitja e koncentratit të plumbit	13,872,955.92	12,440,069.39	7,985,807.20	64.19
2	Të hyrat nga shitja e koncentratit të Zinkut	7,485,125.81	9,695,618.38	8,058,880.22	83.12
3	Të hyrat nga shitja e sulfatit të aluminit	300,000.00	267,630.00	109,260.77	40.83
	Të hyrat nga shitja e ujit industrial			2,172.87	0.00
4	Të hyrat nga shitja e rimorkiove	24,576.30	24,576.30		0.00
5	Të hyrat nga shitja e mbetjeve industriale	190,009.40	107,400.00		0.00
6	Të hyrat nga Qiraja	192,067.44	221,004.24	159,402.83	72.13
7	Të hyrat nga shitja e mbeturinave (skrap)	184,000.00	206,264.66	90,054.80	43.66
8	Të hyrat nga shitjet e imëta	1,860.00	1,860.00	6,641.55	357.07
9	Te hyrat nga shitja e dokumenteve tenderuese				0.00
10	Të hyrat nga kompenzimi i shpenzimeve te EE			148,785.99	0.00
11	Te hyrat tjera			2,139.50	0.00
12	Të hyrat nga Terminali Doganor	60,000.00	100,200.00	96,675.00	96.48
13	Të hyrat nga subvencionet dhe investimet kapitale	2,500,000.00	2,250,000.00	6,817,039.83	302.98
14	Të ardhurat financiare				0.00
Gjithsejt		24,810,594.87	25,314,622.97	23,476,860.56	92.74

Gjatë vitit 2022, progresi i të hyrave në raport me planin e Biznesit nga dy Njësit Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg dhe Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë ka pasur progres.

Tabel 3. 5. Të hyrat e realizuara nga shitja e koncentratit të plumbit dhe zinkut nga tri njësitë prodhuese biznesore; Njësia Biznesore Miniera me Flotacion Trepça Stan Tërg, Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë dhe Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç

Përshkrimi	Stan Tërg dhe Kishnicë- Artanë €	Kopaonik- Leposaviç €	Gjithsej të hyrat €
Të hyrat nga shitja e koncentratit të Pb dhe Zn	16,044,687.42	12,690,861.92	28,735,549.34

4. Përmbledhje e progresit të objektivave kryesore dhe strategjive në ndërmarrjen Trepça Sh.A.

Objektivi kryesor i ndërmarrjes është ta transformojmë Trepça Sh.A. në lider rajonal në prodhimin e koncentrateve të Pb-Zn dhe finalizimin e tyre, duke respektuar normat mjedisore, përkushtimin ndaj profitabilitetit dhe sigurisë së punëtorëve tonë, me qëllim të ngritjes së vlerës ekonomike për aksionarët, investitorët dhe komunitetin.

Synimet e Trepçës janë zbërthyer në një numër objektivash dhe qëllimesh numerike, të cilat duhet t'i arrijnë minierat dhe njësitë biznesore të saj. Plani afarist është një mekanizëm që i shërben ndërmarrjes të orientojë, monitorojë dhe vlerësojë performancën e vet në nivel të njësisve biznesore dhe të përgatisë plane të detajuara veprimi për implementimin e suksesshëm të strategjisë zhvillimore.

4.1. Ndryshimet e nevojshme të cilat do të ndikojnë në arritjen e objektivave të planit të biznesit

Trepça Sh.A objektivi kryesor ka rritjen e prodhimit përmes ngritjes së efikasitetit të shfrytëzimit të mineraleve, hulumtimeve të mëtutjeshme të rezervave gjeologjike, modernizimit të minierave, ngritjes së kapaciteteve përpunuese dhe rritjes së numrit të punëtorëve. Përkundër aktiviteteve për përmirësimin e ambientit, për Trepçën Sh.A. mbetet sfida financimi i vazhdueshëm në përmirësimin (zvogëlimin) e ndotjes minimale të ambientit të cilën e rrethon, ku nevojiten përmirësime që do të ulnin në minimum ndotjen e ambientin.

Tregu në të cilin momentalisht Trepça Sh.A. operon është tregu ndërkombëtar i metaleve. Koncentrati i Plumbit dhe Zinkut blehet nga kompani europiane dhe eksportohet në destinimet e

tyre, koncentratet si produkte finale shiten përmes tenderit publik ndërkombëtar, përderisa furnizimi me material shpenzues dhe makinerik realizohet përmes tregut të brendshëm dhe të jashtëm. Fokusi është prodhimi i koncentratit të Plumbit dhe Zinkut me kualitet sa më të lartë, me qëllim të depërtimit të produkteve tona në të gjitha tregjet botërore të metaleve duke krijuar përparësi konkurruese në raport me prodhuesit tjerë të koncentratit të Plumbit dhe Zinkut. Realizimi i objektivave të Trepça Sh.A. sipas planit të biznesit 2022 ishte drejtpërdrejtë i ndërlidhur me:

- Rritjen e investime kapitale në minerat dhe flotacionet e njësisë biznesore të Trepça Sh.A.;
- Rritjen e eksploatimit të xehës respektivisht të prodhimit të koncentrateve në flotacione;
- Rritjen e kontrollit të kualitetit gjatë flotimit të koncentratit në raport me normativat dhe standardet adekuate;
- Strukturën e moshës së të punësuarve, sidomos në minierë dhe flotacione;
- Aplikimin e teknologjisë informative dhe digjitalizimin e proceseve të punës;
- Aftësimin dhe trajnimet e stafit në fusha përkatëse;
- Mirëmbajtjen dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese teknike-teknologjike me qëllim të ngritjes së produktivitetit dhe zgjerimit të kapaciteteve prodhuese;
- Rritjen e të hyrave dhe maksimizimin e fitimit në të gjitha njësitë e Trepça Sh.A.

4.2. Rreziqet e të ardhmes së korporatës

Rreziqet kryesore të cilat Trepça Sh.A do të ballafaqohet gjatë dy viteve të ardhme janë:

- Gjendja e vazhdueshme e rëndë financiare, borxhet e akumuluar dhe mungesa e mjeteve për investime;
- Mungesa e mjeteve financiare për rivitalizimin e minierave dhe flotacioneve të amortizuara të cilat po krijojnë kosto shtesë prodhuese.;
- Makineritë dhe pajisjet e vjetërsuara dhe humbjet në procesin e pasurimit të xehes;
- Pamundësia e zinxhirit finalizues teknologjik të përpunimit të koncentrateve;
- Fuqi punëtore e moshuar;
- Pensionimi i punëtorëve të kualifikuar;
- Pajisjet e vjetërsuara dhe jo kompatible me metodat bashkëkohore;
- Mungesa e trajnimit për punonjësit;

- Mungesë e strukturave kadrovike, inxhinier të elektros, teknologjisë, përgatitjes së lëndëve minerare (PLM) dhe inxhinier të metalurgjisë;
- Objektet industriale të vjetra, në përgjithësi të amortizuara dhe të vlerësuara si jo efektive për riaktivizim;
- Detyrimet e akumuluar ndaj operatorëve ekonomik;
- Procedurat përmbartimore ndaj Trepçës për obligimet e papaguara (borxhet) nga e kaluara në veçanti çështjet e ngritura në apel;
- Rritja e vazhdueshme çmimeve;
- Kostoja e lartë e energjisë elektrike;
- Ngritja e çmimeve të furnizimeve me lëndë të parë dhe mjeteve themelore për industrinë e minierave;
- Mungesa e konkurrencës për shkak të ikjes së operatorëve ekonomik për shkak të vonësive në pagesa,
- Oscilimet e çmimeve të metaleve në bursën ndërkombëtare,
- Rreziku nga joliquiditeti.

Për uljen e ndikimit të rrezikut veprimet që duhet të ndërmerren

1. Pajisja e minierave me makina të avancuara me produktivitet të lartë;
2. Rritja e eksploatimit të xehes dhe prodhimit të koncentrateve të Pb dhe Zn në të gjitha minierat e Trepça Sh.A.;
3. Rritja e prodhimit të Alumin – Sulfatit në Industrinë Kimike dhe prodhimi i produkteve të reja industriale;
4. Një mundësi e mirë krijimit të hyrave për investime kapitale janë valorizimi i haloiziteve (rreth 3 milion t) dhe mbetjeve industriale (rreth 60 milion t) të Trepçës;
5. Aktivizimi i minierave joaktive;
6. Modernizimi i Flotacioneve me qëllim të reduktimit të shpenzimeve dhe humbjeve;
7. Zgjidhja e kontesteve pronësoresh-juridike dhe financiare nga e kaluara;
8. Integrimi i të gjitha minierave dhe aseteve të Trepçës;
9. Nxjerrja e legjislacionit për çështjet sociale që do të ofronte një zgjidhje të drejtë për punëtorët e Trepçës;

10. Ngritja e vlerave të minierave përmes ngritjes së sigurisë në punë, krijimit të kushteve teknike, zgjerimit dhe verifikimit të rezervave sipas standardeve të njohura ndërkombëtare.
11. Identifikimi, vlerësimi dhe zhvillimi i resurseve dhe pronave me potencial të zhvillimit ekonomik.
12. Zhvillimi/Ekzaminimi i koncepteve për përdorim dhe shfrytëzim alternativ të pronës (përveç lëndës së parë dhe përpunimit të tij).
13. Respektimi i normave mjedisore nga zhvillimet aktuale komfor legjislacionit në fuqi dhe sanimet ekologjike nga e kaluara.

4.3. Investimet kapitale nga BRK

Në kuadër të planit të biznesit për investime kapitale nga buxheti i Republikës së Kosovës për Njësitë Biznesore të ndërmarrës Trepça Sh.A. për vitin 2022 janë realizuar investime kapitale të cilat janë paraparë për këto projekte:

- Hapja e korridorit në vendpunishten e re në Horizontin e XI-të, Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg.
- Hapja e trupit xehërorë nr. I horizonti IV-V, Njësia Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë.

Tabel 4. 1. Investimet kapitale në njësitë biznesore të ndërmarrjes Trepça Sh.A. nga BRK 2022

Përshkrimi		Kontratat e Realizuar (€)
Nr.	Nj. B. Miniera me Flotacion "Trepça" Stan Tërg	
1	Furnizim me kushineta për Minierë	7,941.40
2	Furnizim me material çeliku	18,685.32
3	Furnizim me material nga druri i çamit	7,150.44
4	Furnizim me pompë zhytëse për largimin e ujit nga miniera Hor.XI-të	13,145.80
5	Furnizim me material elektrik për Minierën e Stan Tergut	15,324.65
6	Furnizim me pjesë rezerve për vetngarkues Cavo dhe T2GH	39,825.00
7	Furnizim me bateri industrial për lokomotiva	9,790.46
8	Furnizim me pjesë rezervë për ngarkues nëntokësor	39,958.74
9	Furnizim me pjesë rezervë për pompën Warman 4x4 ST	19,956.16
10	Furnizim me goma të jashtme dhe të brendshme për ngarkues dhe kamion	27,966.00
11	Furnizim me pjesë rezervë për vetngarkues Cavo dhe TTM1	9,971.00
12	Furnizim me dhëmbëzor akse dhe kushineta për ventilator	7,949.80
13	Furnizim me valvula flutur	8,617.54

14	Furnizim me pjesë rezervë për çekan pneumatik dhe këmb pneumatike	8,897.20
15	Furnizim me binarë	36,964.68
16	Furnizim me pjesë për kamiona GHH-Mk-A15	59,990.06
17	Furnizim me pjesë për lokomotiva	24,973.52
18	Furnizim me shtyllore (Stoppers)	20,499.96
19	Furnizim me burgia për Minierë	87,446.22
20	Furnizim me gypa për hidrombushje me hi	64,923.60
21	Furnizim me goma për Cavo	15,210.00
	Gjithësej: - Realizuar	545,187.55
Nr.	Nj. B. Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë	Realizuar
1	Furnizim me goma për Cavo	5,782.00
2	Furnizim me pjesë rezervë për lokomotiva për Minierën e Artanës	27,235.82
3	Furnizim me makina ngarkuese transportuese për Minierë	77,880.00
	Gjithësej - Realizuar	110,897.82
Nr.	Nj. B. Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç	Realizuar
1	Mekanizmi ngarkues-transportues për miniera dhe mekanizmi ndërtues për përdorim të jashtëm	170,000.00
	Gjithësej - Realizuar	170,000.00
Gjithësej Planifikuar -Realizuar		826,285.37
Nga BRK		820,000.00
Nga burimet vetanake		6,285.37

4.4. Investimet kapitale nga buxheti vetanak

Gjatë vitit 2022 përveç investimeve kapitale nga BRK janë realizuar edhe investime kapitale nga burimet vetanake në njësitë biznesore të Trepça Sh.A të cilat janë të shpalosura në tabelën 4.2.

Tabel 4. 2. Investimet kapitale nga buxheti vetanak në Trepça Sh.A.

Nr.	Përshkrimi	Kontratat e realizuara (€)
1	Furnizim me pompa për horizontin e V dhe horizontin e IX	23,699.12
2	Pastrimi i shtratit të pendes së lumit të ujit industrial	2,374.80
3	Furnizim me drunjë për kambatisje në minierë.	9,440.00
4	Furnizim me goma për Cavo dhe T2GH	9,103.70
5	Furnizim dhe montim me nderprerës 3.3KV në Ventilator	7,894.20
6	Kontrollimi dhe riparim i tiristorit	1,900.00
7	Furnizim me tepih gome dhe pajisje mbrojtëse për trafostatcion	12,862.00
8	Shqyrtim dhe verifikim i trafove në Kizhnice dhe Artanë	3,127.00
9	Sherbimet për pastrimin e kanalit në pendën e Kelmendit si dhe disa punëve tjera	1,680.32
10	Furnizim me pompa zhytëse për Minier	4,790.80
11	Furnizim me pompë të presionit të naftes për makinat ngarkuese në Minierë	2,194.00

12	Furnizim me paisje për Kuzhinë për mensën e Kishnicës	3,322.88
13	Furnizim me motora për makina nëntoksore ngarkuese	28,261.00
14	Furnizim me thika të ushqyesit të mullirit nr.2	7,998.28
15	Furnizim me pompa për hidrombushjen me hi	19,906.60
16	Furnizim me teknikë të bardhë për mensën e Kishnicës	12,395.90
17	Furnizim me pjesë rezervë për sistemin e pompimit	24,815.40
18	Servisimi i kompresorit	6,998.00
19	Furnizim me një traktor	16,000.00
20	Servisimi i peshorës 31-2	1,990.00
21	Furnizim me prexh për Minierë	22,361.00
22	Furnizim me material për riparimin e trafos 35 6 Kv,8MVA-Flotacion	4,998.46
23	Furnizim me material për mbulojen e objektit të drejtorisë ku përfshihet edhe mjekësia e punës	29,607.50
24	Furnizim me Pompa për Minierë	44,840.00
Gjithsejt		302,560.96


ANNEX 1

Çështjet kryesore ligjore të proceduara gjatë vitit në Trepça Sh.A.

Zyra Ligjore e Ndërmarrjes Trepça Sh.a ka bërë një përmbledhje të punës gjatë vitit 2022. Procedurat që i kemi ndërmarrë dhe rastet që i kemi në proces, në pritje të vendimeve gjyqësore, marrëveshje, llogari të bllokuara, rregullore të miratuara janë si ne vijim:

- Padi me Propozim për masë të sigurisë gjithsejtë janë 3 Padi. (Refuzim i masës së sigurisë , në Proces dhe Pajtim Gjyqësor).
- Padi nga ana e Trepçës për lirimin e pronës dhe fitimin e humbur janë gjithsejtë 4 Padi, të cilat janë në proces.
- Padi nga ana e Trepçës për kompensimin e dëmit të shkaktuara me vepër penale (vjedhje) janë gjithsejtë 1 Padi e cila është në proces.
- Dërgimi i kërkesave për Lirimin e pronës janë gjithsejtë 3 kërkesa për lirimin e pronës të cilat janë në proces.
- Kallëzime Penale për Uzurpim të pronës janë gjithsejtë 3 kallëzime penale , të cilat janë në proces.
- Propozimet për Përmbartim për vitin 2022 janë gjithsejtë 13 Propozime , ku kemi Ekzekutim Borxhi 9 Propozime, Llogari të bllokuara 1 propozim , kemi 2 me Marrëveshje për pagim paraprak, dhe 1 në pritje të Vendimit të Gjykatës.
- Çështjet banesore të përfunduara në vitin 2022 janë gjithsejtë 16 Lëndë, ku shitësi ka qenë Trepça SH.A dhe blerësi personat fizik, objekt i blerjes ka qenë Banesa.
- Hartimi i rregulloreve për vitin 2022 , gjithsejtë 7 Rregullore të miratuara.

U.D. Kryeshef Ekzekutiv i Trepça Sh.A.



Dr. Sc. Enis Abdurrahmani

